



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0916
Data e Vendimit: 30.09.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Jetmir Lubovci B.I." kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Transporti i nxënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit - për vitin kalendarik 2025-2026 6 Lot" me numër të prokurimit 624-25-4586-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK Komuna Suharekë, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 30.09.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si palejuar, ankesa e "Jetmir Lubovci B.I." me nr. të protokollit 2024/0961, e datës 17.09.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Transporti i nxënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit - për vitin kalendarik 2025-2026 6 Lot" me numër të prokurimit 624-25-4586-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK Komuna Suharekë, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna Suharekë që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e "Transporti i nxënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit - për vitin kalendarik 2025-2026 6 Lot" me numër të prokurimit 624-25-4586-2-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 17.09.2025, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 0961/2025 nga OE "Jetmir Lubovci B.I." lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Transporti i nxënësve dhe shërbimet tjera brenda vendit - për vitin kalendarik 2025-2026

6 Lot” me numër të prokurimit 624-25-4586-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK Komuna Suharekë në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 15.06.2025 Komuna Suharekë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë.

Me datën 09.09.2025 AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës B58.

OE "Jetmir Lubovci B.I." me 09.09.2025 ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 11.09.2025 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së për refuzim, Operatori Ekonomik "Jetmir Lubovci B.I.", me 17.09.2025, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 961/25 (Nr. protokolli).

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave* –

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimit në OSHP, konstatohet se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar për faktin se OE ankues në marrëveshjen e konzorciumit të bashkangjitur në Ofertën e GOE ku bën pjesë nuk është përcaktuar si lider i GOE respektivisht si i autorizuar për parashtrim të ankesës në OSHP.

Sipas Rregullores për prokurimin publik – Versioni i konsoliduar nenit 26 paragrafi 15 thuhet se: *26.15 Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t'i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t'i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP.*

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Jetmir Lubovci B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: